



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:169693
Datë: 20.03.2024
Numri i dokumentit: 05481551

C.nr.930/20

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË, Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtaren Mirjeta Shala, duke vendosur në çështjen juridike të ... Sh.a (K.), Bulevardi “.. nr.3 – Ndërtesa e .., Kati II, nr.5 – Prishtinë-Distrikrit në Gjakovë, të cilën e përfaqëson i autorizuari T.G., me autorizim në shkresat e lëndës, kundër të paditurës F.B., nga fshati ..., Komuna e Gjakovës, për kompensim të dëmit material, vlera e kontestit 321,69 €, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të mbajtur, në prezencën e të autorizuarit të paditëses dhe në mungesë të paditurës, me datë 14 mars 2024, mori këtë;

A K T G J Y K I M

APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditëses . Sh.a (..S) – Prishtinë - Distrikrit në Gjakovë dhe DETYROHET e paditura F.B., nga Komuna e Gjakovës, që paditëses në emër të kompensimit të dëmit material t’ia paguaj shumën prej 321,69 € (treqind e njëzetënjë euro e gjashtëdhjetë cent), me kamatë ligjore prej 8%, e cila fillon të rrjedhë nga data e parashtrimit të padisë 03.12.2020 deri në pagimin definitiv, si dhe shpenzimet procedurale në lartësi prej 20,00 €, e gjitha këto në afatin prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcenim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësja me datën 03.12.2020 në këtë gjykatë ka parashtruar padi, kundër të paditurës F.B., për shkak të kompensimit të dëmit material në vlerë prej 321,69 €. Në padi dhe nëpërmes të autorizuarit të saj gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridiko-civile dhe në fjalën përfundimtare ka theksuar se e padituri është përgjegjëse për demin e shkaktuar në lartësi prej 321,69 euro kjo pasi që nga aktgjykimi penal me numër P.nr.203/17 i po kësaj gjykate i formës se prere nga data 16.01.2018, i padituri është shpallur fajtor për te gjitha pikat e aktakuzës, ndërsa lartësia e demit është vërtetuar ne bazë te Rregullores për procedurën e identifikimit dhe parandalimit te shfrytëzimit te paautorizuar te energjisë elektrike përkatësisht neni 15 i saj, ku ne baze te faturës rezulton te jete vlera e kërkesë padis. Lartësia e dëmit vërtetohet në bazë të faturës së kalkulimit me numër 64812 të datës 19.07.2016. Andaj duke qene qe është vërtetuar edhe baza dhe lartësia e kërkesës padisë i ka propozuar gjykatës qe padia dhe kërkesëpadia te aprovohet si e bazuar dhe te detyrohet i padituri, që t’ia paguajë borxhin me vlerë prej 321,69 euro, si dhe shpenzimet e procedurës ne emër e taksës gjyqësore për padi ne vlerë prej 20, 00 euro.

Gjykata në kuptim të nenit 423.4 të LPK-së, shqyrtimin kryesor e mbajti në mungesë të paditurës e cila ishte e ftuar në mënyrë të rregullt, nuk ka prezantuar dhe mungesën nuk e ka arsyetuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në shqyrtimin kryesor-publik, administroi këto prova: Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm me nr. P.nr.203/17 i datës 25.10.2017, i plotfuqishëm me datë 16.01.2018; Fatura mbi përllogaritjen e demit e datës 19.07.2016, si dhe Fatura e kthimit të humbjeve e datës 19.07.2016.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palës paditëse dhe provave të nxjerra, në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

- *Gjendja faktike e vërtetuar:*

Nga Aktgjykimi penal i Gjykatës Themelore në Gjakovë, me nr. punues P.nr.203/17, i datës 25.10.2017, i cili e ka marrë formën e prerë me datë 16.01.2018, vërtetohet se i padituri i lartpërmendur është shpallur fajtor, për veprën penale : vjedhje e shërbimeve komunale, nga neni 320/1 i KPRK-së dhe gjykata në rastin konkret në kuptim të nenit 4, 17, 41, 46, 49, 50, 51, 52 par.5, 73 dhe neni 320/1 të KPRK-së, si dhe neni 365, të KPPK-së, e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre (tre) muajve, si dhe dënim me gjobë në shumën prej 100,00 €, të cilat dënime nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 viti, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, ndërsa të dëmtuarën, këtu paditësen e ka udhëzuar që të drejtën e saj për kompensim të demit, të e realizojë në kontest civil.

Nga fatura DGJ16HP06072, e datës 19.07.2016, u vërtetuar rrethana se dëmi i shkaktuar është në vlerën prej 321.69€. Ndërsa transaksioni i konsumatorit me numër DGJ16HP06072 i datës 19.07.2016, gjykatës i ka vërtetuar rrethanën se i padituri nuk e ka ndërmarr veprime ne drejtim te pagesës se shumes prej 321.69euro, ne emër te rikthimit te humbje si rezultat i demit te shkaktuar me vepër penale.

- *Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës*

Me neni 137 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, i publikuar në “Gazetën Zyrtare” të Republikës së Kosovës nr. 16, me datë 19.06.2012 (i cili është në implementim nga data 20.12.2012, parashihet që “Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”, ndërsa me nenin 154 par. 1 të parashihet që “Kush i shkaktonte tjetrit dëm ka për detyrë t’u kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”. Në anën tjetër me neni 14 të Ligjit Nr.06/L-006 për Procedurën Kontestimore parashihet që “Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor.

Gjykata nga administrimi i provave, vlerësimet dhe analizimet të tyre, pretendimet e paditësit se i padituri i ka shkaktuar dëm paditëses i gjen të bazuara. Nisur nga fakti se i padituri me aktgjykimin penal P.nr.203/17 i datës 25.10.2017 të formës së prerë nga data 16.01.2018 është shpallur fajtor për veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 i KPRK-se, rrjedh se për gjykatën është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadisë së paditëses, pasi që në rastin konkret gjykata lidhet me aktgjykimin penal i cili është i formës së prerë ku është vërtetuar përgjegjësia penale e të paditurit, kjo bazuar në nenin 14 të LPK-së ku është përcaktuar se “*Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor.* Ndërsa sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, gjykata vendosi duke marrë për bazë fatura DGJ16HP06072, e datës 19.07.2016, sipas të cilës është konstatuar se i padituri me shfrytëzimin e energjisë elektrike në mënyrë të pa autorizuar i ka shkaktuar dëm palës paditëse në vlerën prej 321.69.€. Ne anën tjetër, i padituri në asnjë mënyrë nuk ka argumentuar se dëmi i lartcitur i paditëses, është shkaktuar pa fajin e tij.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata erdhi në përfundim se i padituri me veprimet e tij paditëses i ka shkaktuar dëm në lartësi prej 321.69. euro, fakte këto që u vërtetuan nga provat e administruara dhe të elaborara si më lartë. Andaj si rezultat i kësaj gjendje faktike të vërtetuar e në zbatim të dispozitave ligjore nga neni 137 dhe 154 i LMD-së, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8 %, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur prej e llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u muar sipas nenit 450.1 të LPK-së dhe suksesit në kontest, ashtu që paditësit në emër të shpenzimeve procedurale iu pranua shuma prej 20,00 €, në emër të taksës gjyqësore të paguar për padi.

Nga të lart cituarat, e në kuptim të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr. 930/20, datë 14 mars 2024

Gj y q t a r j a,
Mirjeta Shala

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar Ankesa në afatin prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj Gjykate.